

ENIS SULSTAROVA

## IDEJA E PËRKATËSISË EUROPIANE NË DEBATET INTELEKTUALE NË SHQIPËRINË E VITEVE 20-30

### Hyrje

Kur flitet për një identitet evropian, shpeshherë ky krahasohet me atë kombëtar. Studiues të ndryshëm argumentojnë për pamundësinë, ose në rastin më të mirë, “cekëtinë” e identitetit evropian përballë atij kombëtar,<sup>1</sup> ose për mënyrën sesi identiteti evropian po fiton terren prej zbehjes së identiteteve kombëtare në Evropës si pasojë e globalizimit ekonomik dhe kulturor.<sup>2</sup> Mirëpo, duhet theksuar se marrëdhëniet midis kombeve evropiane dhe idesë së Evropës janë të ndërvarura: jo vetëm kombet e parë modernë janë formuar në mjedisin e qytetërimit evropian a perëndimor, por gjithashtu “Evropa” dhe projekti për bashkimin politik gjithëevropian janë konsideruar prej këndvështrimeve të kombeve të kontinentit. Kjo është arsyeja pse asnjëherë nuk ka pasur një “Evropë” thelbësore, por gjithmonë shumë përfytyrime të Evropës.<sup>3</sup> Kjo do të thotë se epitetet “evropian” dhe “kombëtar” nuk janë alternativa të njëri-tjetrit, por artikulohe në bashku në mënyra të shumëfishta.<sup>4</sup> Këtu do të trajtojmë artikulet e “Evropës” në debatet publike mbi zhvillimin e shtetit kombëtar shqiptar në periudhën midis dy luftërave botërore. Pyetja së cilës do të mundohemi t’i përgjigjemi është se cilat janë përdorimet e “Evropës” te ligjërimet intelektuale të kohës, në varësi edhe të projekteve politike për të ardhmen e vendit që parashtroheshin prej intelektualëve.

Rasti i Shqipërisë midis dy luftërave botërore është domethënës për të studiuar kuptimet e “Evropës” në proceset komb-formuese në periferinë e kontinentit. Shqipëria është një prej shteteve të rinj kombëtarë të Evropës Lindore që u krijuan, ose rifituan pavarësinë me shpërbërjen e perandorive

---

<sup>1</sup> Shih p.sh. Anthony Smith, “National Identity and European Unity”, në: *The Question of Europe*, përg. Peter Gowan dhe Peter Anderson, London dhe New York: “Verso”, 1997.

<sup>2</sup> Shih Jurgen Habermas, *The Postnational Constellation*, Cambridge, Mass: “The MIT Press”, 2001.

<sup>3</sup> Mikael Malmborg dhe Bo Strath, “Introduction: The National Meanings of Europe”, në: *The Meaning of Europe: Variety and Contention within and among Nations*, Oxford dhe New York: “Berg”, 2002.

<sup>4</sup> Po aty, f. 6.

habsburgase, osmane dhe cariste. Elitat politike dhe kulturore të shteteve të rinj kombëtarë shikonin për nga Evropa Perëndimore për të siguruar legjitimitet, frymëzim moral, udhëzime si edhe ndihmë materiale për modernizimin e vendeve të tyre. Mirëpo në atë kohë vetë qytetërimi perëndimor ndodhej në krizë dhe Evropa po kthehej në atë që një historian e ka quajtur “kontinenti i errësirës”.<sup>5</sup> Por duke i krahasuar vitet 20-30 me humbjen e pavarësisë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe, më pas, me përfshirjen e shumë prej tyre në perandorinë komuniste, në kujtesën historike të këtyre shteteve kombëtare koha midis dy luftërave shpesh konsiderohet si pika më e lartë e aspiratës së tyre për të bërë pjesë në qytetërimin evropian/perëndimor. Integrimi i tanishëm i shteteve kombëtare ish-komuniste në Bashkimin Evropian dhe NATO përfytyrohet si “kthim në Evropë”, prandaj vitet midis dy luftërave botërore shihen me nostalgji si një kohë kur kombi ishte pjesë e “qytetërimit”, përpara se të robërohej prej “barbarizmit” komunist.

Shqipëria nuk bën përjashtim nga kjo tendencë e shikimit mbrapa te periudha midis luftërave. Ligjërimi dominues politik në Shqipëri e portretizon komunizmin si një shkëputje tjetër me kursin natyror të Shqipërisë drejt Perëndimit dhe intelektualët shqiptarë kërkojnë të “rilidhin” kulturën e tanishme publike me idetë që lulëzonin në shtypin shqiptar në vitet 20-30, në mënyrë që të ofrojnë një rigjallërim moral dhe shpirtëror bashkëkohor për identitetin kombëtar, si edhe një udhëzim kulturor për proceset integruese drejt BE dhe NATO-s. Ky artikull përpiket të adresojë dhe kritikojë këtë tendencë. Më poshtë tregojmë se si vërtet ka ekzistuar në atë kohë një ligjërim dominues për “arratisjen” prej Lindjes/Azisë dhe “rikthimin” në Perëndim/Evropë, por nën këtë ligjërim kishte kuptime më të nuancuara të idesë së Evropës, në varësi të projeksioneve të ndryshme nga intelektualë të veçantë të zhvillimit dhe të ardhmes së Shqipërisë.

Argumenti ynë zhvillohet në tri pjesë vijuese. Pjesa e parë shqyrton variantin shqiptar të orientalizmit, më të cilin kuptojmë përfytyrimin e botës të ndarë në dy qytetërimë kundërvënëse ndaj njëra-tjetrës: Lindja dhe Perëndimi.<sup>6</sup> Kategoritë kundërvënëse të Perëndimit dhe Lindjes shoqëroheshin me polarizime të tjera si modernia përkundër primitives, rinia përkundër vjetërsisë, risia përkundër traditës, përparimi përkundër prapambetjes, laicizmi përkundër fanatizmit, emancipimi përkundër robërisë, shteti kombëtar përkundër Perandorisë Osmane, etj. Zinxhiri perëndimor i shënjesve në ligjërim paraqitej

<sup>5</sup> Mark Mazower, *Dark Continent: Europe's Twentieth Century*, New York: “Vintage”, 1998.

<sup>6</sup> Vepra klasike për kritikën e orientalizmit është Edward W Said, *Orientalism*, New York: “Vintage”, 1978; për variantin shqiptar të orientalizmit shih Enis Sulstarova, *Arratisje nga Lindja: Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja*, Tiranë: “Dudaj”, botimi i parë 2006, botimi i dytë 2007.

si tendenca moderne e identitetit kombëtar shqiptar, kurse zinxhiri tjetër i shënjesve rreth nyjes “Orient” paraqitej si dekadencë, si tipare që mund t’i ishin ngjitur identitetit shqiptar dhe që duheshin refuzuar e hedhur tutje me vendosmëri.

Pjesa e dytë shqyrton alternativat nga e djathta dhe e majta dhe përdorimet përkatëse të idesë së Evropës për të legjitimuar këto alternativa. Në kushtet e sundimit zogist (1925-1939) nuk ishte fjala për parti politike, por për disa grupime të intelektualëve rreth rrymave të mendimit, të cilat ishin të ndikuara nga idetë dhe ideologjitë bashkëkohëse në Evropë. Në këtë kuadër, ideja e Evropës fitonte kuptime të ndryshme, sipas secilës rrymë. Megjithëse nuk mund të flasim për ndarje të qarta ideologjike, ne mund të konsiderojmë të djathtë “neoshqiptarizmin” e Branko Merxhanit dhe “diktaturën e ndritur” të Ismet Totos. Këto rryma ishin në favor të varianteve të ndryshme të regjimit nacionalist dhe autoritar që do të krijonte një komb modern shqiptar që të ishte njëherazi “organik” dhe modern. Kurse në të majtë mund të vendosim “demokratët”, si Nonda Bulka, Selim Shpuza, Petro Marko, Migjenin etj., të cilët ishin edhe ata për një Shqipëri të zhvilluar dhe moderne, por ku pushteti të ushtrohej nga klasat e punëtorëve dhe fshatarëve. Këta të fundit për aq sa lejonte censura shtetërore mbi shtypin, artikulonin nevojën për shndërrime radikale klasore të shoqërisë shqiptare. Pjesa përmbyllëse e lidh argumentin tonë me debatet e sotme mbi integrimin evropian të Shqipërisë dhe të vendeve të tjera ish-komuniste.

### **Orientalizmi shqiptar**

Brenda ligjërimeve politike dhe kulturore të kohës fjala “oksidantalizim” shenjonte aspiratën për modernizimin dhe zhvillimin e Shqipërisë sipas modeleve të shteteve kombëtare të Perëndimit. Me “oksidantalizimin” lidheshin një varg kërkesash shoqërore që duhej t’i përkisnin shtresave shoqërore e interesave të ndryshme, që nga apologjetët e regjimit, burokratët e shtetit, që nga monarkistët e deri te republikanët, që nga ata që mbronin shenjtërinë e pronës private e deri te ata që kërkonin reformë agrare, që nga ata që kërkonin diktaturën e deri te ata që paraqiteshin si demokratë e liberalë. Në një rast të veçantë, në vitin 1922 gazeta *Fjalë e lirë* e Vlorës madje edhe fjalën “Oksidentalisma” e zbërthente në një program politik:

- O – Operacione [shkurtime] në nëpunësa;
- K – Konkencione për zhvillimin ekonomik;
- S – Shkurtime në çdo degë të administratës;
- I – Izolim i të ligut dhe të pamoralit;
- D – Demokraci me fakte e jo me fjalë;
- E – Energji në legalitet të drejtësisë;
- N – Nacionalizëm me tru e jo me ngjyrë;
- T – Taksa të lehta sipas fuqisë;

A – Asamble Kushtetuese në rast të favorshëm;  
 L – Liri për shtyp por me frena llastiku;  
 I – Irrendentizëm për moralin kombëtar;  
 S – Sinqeritet në shpenzime e n'urdhra;  
 M – Miqësi me shtetet që u shkon fjala;  
 A – Afrim i elementit të duhur të opozitës në bashkëpunim.<sup>7</sup>

Siç e vumë në dukje më sipër, në tekstet e intelektualëve të kohës, “Oksidenti” shënjonte “qytetërimin perëndimor” dhe në terma gjeografike ai zakonisht mbulonte Evropën perëndimore dhe SHBA, por ndonjëherë aty përfshihej edhe Evropa qendrore. Për shembull, në një tregim të Migjenit, personazhi i një studenti shqiptar në një qytet të pacilësuar të Evropës qendrore, kthehet në vendlindje, në Shkodër dhe duke e parë veten si bartës të mendësisë së ndriçuar evropiane, përpiqet të emancipojë familjen e tij tradicionale. Rrëfimi i tij për mënyrat e jetesës së banorëve, sidomos të rinjve, në qytetin e Evropës qendrore simbolizon sjelljet e qytetërimit perëndimor në tërësi.<sup>8</sup> Pothuajse të gjithë intelektualët aktivë me shkrimet e tyre në shtypin e kohës ishin “perëndimorizues”, përfshirë edhe ata me simpati të majta që shprehnin kritika për borgjezinë evropiane. Sërish Migjeni përfaqëson tendencën e kohës me vargjet e tij:

Kangë Përndimi, kangë njeriu të dehun nga besimi në vete  
 Kanga e tij shpres' e bukur, me flatra të një tjetër jete;  
 Në të cilën dielli do ndrorojë udhën; ka për t'u lindë nga Përndimi.<sup>9</sup>

Imazhet e Oksidentit ushtronin një tërheqje të fuqishme te intelektualët, sepse ai përfaqësonte një model të përparuar shoqëror dhe kulturor që ata dëshironin të zbatohet në vendin e tyre. Qasja e tyre ndaj “oksidantizimit” ishte esencialiste, sepse nisej nga pikëpamja se meqë shqiptarët ishin një popull i lashtë evropian dhe i përkisnin Evropës që nga agimi i historisë njerëzore, atëherë edhe fati i tyre duhej të ishte qytetërimi evropian. Me fjalë të tjera, “oksidantizmi” i shqiptarëve buronte nga thelbi i tyre. Ja si shprehej Ismet Toto në një artikull të vitit 1936:

Shqipëria të evropianizohet, të bëhet një Zvicër në Ballkan... Logjika e historisë, pozita jonë gjeografike, zotësitë shpirtërore të popullit tonë dhe gjithë ç'është e mirë dhe fisnike në këtë vend, na shtrëngojnë patjetër të

<sup>7</sup> Cituar sipas Hysen Kordha, “Revolucioni i Qershorit 1924 – përpjekje tjetër për afrimin e Shqipërisë me Evropën”, *Studime historike*, Tiranë, 2001, nr. 3-4, f.179-180.

<sup>8</sup> Migjeni, *Veptra*, Tiranë: “Hiva”, 1998, f.131-152.

<sup>9</sup> *Po aty*, f.37-38.

zgjedhim rrugën e evropianizimit, e përqafimit të parimeve morale dhe të mjeteve e mënyrave që ka shpikur shkenca dhe qytetërimi i këtij kontinenti.<sup>10</sup>

Nëse “oksidantalizmi” i shqiptarëve buronte nga qenia e tyre evropianë, atëherë pse ekzistonte një hendek kaq i madh midis Oksidentit/Evropës dhe Shqipërisë? Cili duhej fajësuar për ndalimin e shqiptarëve për të qenë perëndimorë, për të qenë vetvetja? Sipas intelektualëve, faktori kryesor ishte trashëgimia e Perandorisë Osmane, sepse kjo e kishte “ndotur” shpirtin e shqiptarit me ndikime orientale. Kjo është arsyeja pse ata në kohën e tyre flisnin për një luftë që po zhvillohej në shoqërinë shqiptare midis “oksidantëve” dhe “orientalëve”. Për shembull, sipas një artikulli të Krist Malokit më 1937, te tipi i oksidentalit përfshiheshin ata pak individë që punonin shumë dhe flijoheshin për të mirën e kolektivit, ndërsa tipi i orientalitetit përfshinte shumicën, e cila përbëhej nga ata që jetonin në mënyrë përtacore dhe egoiste. Nëse kishte solidaritet midis orientalëve, ai ishte solidariteti i ujqërve për të shqyer prenë, por edhe për të sulmuar ndonjë nga të vetët nëse kjo u leverdiste.<sup>11</sup>

Kush janë orientalët shqiptarë? Shigjetat e intelektualëve drejtoheshin në radhë të parë ndaj burokratëve të shtetit. Sipas tyre, kjo kategori ishte në pjesën më të madhe mbetje e sistemit të vjetër osman dhe, për pasojë, ishte e mbrujtur me mendësi dhe sjellje të vjetra orientale, që nuk duhet të kishin vend në një Shqipëri të re dhe perëndimore. Kështu, Foqion Postoli shkruante në fillim të viteve 20 se shumica e zyrtarëve të administratës shqiptare kanë një mendësi aziatike dhe se ata luftonin kundër gjithçkaje që përfaqësonte përparimin dhe qytetërimin oksidental. Ai kishte shpresë se pakica e shëndetshme e zyrtarëve me mendësi perëndimore që ekzistonte akoma në mesin e tyre do ta mundte shumicën, sepse përfaqësonte frymën e kohës.<sup>12</sup> Ndërsa Selim Shpuza në një shkrim të mesit të viteve 30 thotë se perspektivat e oksidentalëve dhe orientalëve shqiptarë janë të papajtueshme:

Orientali shoqin në anakronike e të vjetrueme të soçme të Shqypnisë, të cilën la trashëgim sundimi otoman, e konsideron si shoqinë ma të mirë, ma të bukur dhe ma ideale qi mund të ketë pasë e qi mund të ketë bota; kurse oksidentali, ai qi e shiqon botën dhe jetën tonë të brendshme me gjyslykët e një evropiani, nuk mundet me u knaqë me vorfninë dhe me injorancën e madhe të vendit tonë dhe kurrsesi nuk mundet m’e kuptuam arsyen përse shqiptarët të vuejnë në një vend me pasuni natyrale aq të

<sup>10</sup> Ismet Toto, *Bota e një djali kryengritës*, Tiranë: “Toena”, 1997, f.60.

<sup>11</sup> Krist Maloki, “Oriental apo oksidental” [1937], në: *Antologji e mendimit shqiptar 1870-1945*, përg. Ndriçim Kulla, Tiranë: “Plejad”, 2003, f.636-643.

<sup>12</sup> Foqion Postoli, *Vepra letrare, vëll. 1*, Tiranë: “Naim Frashëri”, 1990, f.321-322.

shumta sa me muejt me ushqye mirë e si duhet edhe katër-pesë milion të tjerë.<sup>13</sup>

Këta intelektualë, shumica e tyre në moshë të re, protestonin që administrata shtetërore ishte në duart e njerëzve të korruptuar dhe konservatorë, të cilët dinin vetëm metodat dinake të burokracisë së mykur osmane dhe ishin jashtë realiteteve bashkëkohore evropiane. Për t'i kënaqur këta zëra, mbreti Zog më 1935 formoi një qeveri të re me ministra të rinj dhe "liberalë", siç u quajtën në atë kohë. Qeveria "liberale" e Mehdi Frashërit u brohorit në shtyp nga disa intelektualë si lindja e një ere të re në Shqipëri. Por eksperimenti i Zogut me "liberalizmin" ishte jetëshkurtër. Për shkak të shqetësimeve të brendshme të sigurisë dhe të trysnisë së jashtme të Italisë, mbreti vendosi që të rikthehej te bashkëpunëtorët e tij "të vjetër" dhe qeveria e Frashërit dha dorëheqjen. Këto ishin zhvillime zhgënjyese për intelektualët "e rinj" që e vazhduan betejën kundër "të vjetërve" edhe për pak kohë, deri në pushtimin e vendit nga Italia më 1939.

#### **Alternativat nga e djathta dhe e majta**

Përplasja midis ideologjive të majta dhe të djathta në Evropën e kohës u pasqyrua edhe në debatin e intelektualëve në Shqipëri, të cilët kërkonin, huazonin dhe përshtatnin për kushtet e vendit idetë që debatoheshin atëherë në Shqipëri. Ajo që të bie në sy është mungesa e zërave që kërkojnë për vendosjen e demokracisë liberale në vend. Sigurisht që demokracia liberale nuk mund të artikulohej lirisht në shtyp për shkakun e censurës, por kishte edhe arsye të tjera. Shumë nga intelektualët mendonin se vendi nuk ishte gati për demokracinë liberale, sepse ai ishte i prapambetur, nuk kishte klasë të mesme të fuqishme, mungonte arsimi i mjaftueshëm i popullatës, mungonte toleranca e përgjithshme në një vend ku një pjesë e mirë e popullsisë ishte akoma e armatosur etj. Ata kishin frikë se demokracia do ta shpinte vendin në anarki. Megjithëse Anglia, Franca dhe SHBA vlerësoheshin prej tyre si bartës të qytetërimit perëndimor dhe shpeshherë edhe Zvicra merrej si ideali që duhej të arrinte Shqipëria, prapëseprapë modeli i regjimit politik që shumë intelektualë kërkonin të zbatonin në Shqipëri ishte një nga variantet e autoritarizmit ose diktaturës, që i jepte shtetit një rol parësor në reformimin shoqëror. Prandaj modernizimi dhe "oksidentalizimi" i Shqipërisë për disa mund të arrihej me anë të qemalizmit, autoritarizmit, "diktaturës së ndritur", ose siç propagandonin fshehurazi simpatizantët e Bashkimit Sovjetik, diktaturës së klasave proletare dhe fshatare.

---

<sup>13</sup> Selim Shpuza, *Vitet 20-30 në publicistikë dhe histori*, Tiranë: "Toena", 1999, f.96-97.

Një mbrojtje e ndrojtur e liberalizmit politik u artikulua nga Branko Merxhani, i cili këshillonte për një rrugëtim gradual të monarkisë drejt “demokracisë së disiplinuar”, së pari duke lejuar një liri të përgjegjshme shtypi, e cila do të formonte një opinion të shëndoshë publik, më pas të lejohej zgjedhja e drejtpërdrejtë e kandidatëve me anë të votës në qytetet e mëdha dhe vetëm kur të piqeshin kushtet e nevojshme kjo gjë të realizohej në tërë vendin.<sup>14</sup> Mirëpo megjithëse ai as nuk përmendte partitë politike, u akuzua nga Krist Maloki se po kërkonte të krijonte në Shqipëri një “dallavere orjentale”. Me këtë ai paralajmëron se po t’u jepet vota shtresave të ulta, gjithçka do të degjenerojë në një tregti të ulët votash dhe mund të rikthehet anarkia e viteve 1920-1924. Maloki lavdëron zgjidhjet e krizës shoqërore që Hitleri dhe Musolini kishin realizuar në vendet e tyre, duke mobilizuar dhe disiplinuar masat për realizimin e qëllimeve kombëtare. Për Shqipërinë ai mendon se diktatura personale, si ajo e Hitlerit në Gjermani nuk është e përshtatshme dhe rekomandon vendosjen e një sistemi autoritar si ato të Italisë, Austrisë apo Estonisë.<sup>15</sup>

Kishte intelektualë që mendonin jo vetëm se demokracia nuk ishte e përshtatshme për shqiptarët, por edhe që sistemi liberal-demokratik në vetvete ishte i kapërcyer në Evropë. Sipas tyre, Shqipëria duhej të pajisej me një “diktaturë të ndritur”, të ngjashme me regjimet fashiste të kohës. Mbrojtësi më i zëshëm i kësaj alternative të djathtë për reformimin e sistemit politik ishte Ismet Toto. Nga mesi i viteve 30 ai thoshte se beteja e “të rinjve” kundër “të vjetërve” ishte pjesë e lëvizjes së rinisë botërore në shekullin e ri kundër botës së vjetër. Problemi që duhet të zgjidhte shteti shqiptar ishte se si të organizohej rinia shqiptare sikundër Hitleri dhe nazistët kishin organizuar rininë gjermane, e cila do të ishte në ballë të krijimit të një Shqipërie organike dhe të regjimentalizuar që do të vepronte si një e vetme: “Një klimë e fortë nacionaliste, një riorganizim shoqëror, një disiplinë dhe rregullim i të gjitha klasave të popullit dhe interesave të tyre, një veprimtari e fuqishme drejt oksidentalizmit, kjo është Shqipëria ideale”.<sup>16</sup> Kjo mund të realizohej vetëm me anë të një diktature me perspektivë oksidentale:

Ne Shqipërinë e duam të fuqishme, ne Shqipërinë e duam të organizuar si shtetet e tjerë të Evropës, ne Shqipërinë e duam të përparuar. Mjaft me Orientin... Dhe ne kërkojmë Diktaturën, sepse Diktatura, vetëm Diktatura, do të ngjallë në zemrën e popullit këto pasione; sepse Diktatura, vetëm Diktatura do të ngrejë nga errësira e padijes në dritën e diturisë turmat

<sup>14</sup> Branko Merxhani, *Vepra*, Tiranë: “Plejad”, 2003, f.409; shih edhe Viron Koka, *Rrymat e mendimit politik-shoqëror në Shqipëri: Vitet 30 të shek. XX*, botim i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Tiranë: 1985, f.104.

<sup>15</sup> Krist Maloki, *Refleksione*, Prishtinë: “Faik Konica”, 2005, f.161-165.

<sup>16</sup> I. Toto, *Bota e një djali...*, f.79.

shqiptare; sepse Diktatura do të shenjtërojë ndjenjat, do të falë shëndetin, do të evropianizojë Atdhenë e Kastriotit.<sup>17</sup>

Sipas tij dhe të tjerë përkrahësve të “diktaturës së ndritur”, liberalizmi kishte vdekur në Evropë dhe beteja po zhvillohej midis diktaturave të majta dhe të djathta.<sup>18</sup> Sa për shqiptarët, ata kurrë nuk kishin përjetuar demokracinë në historinë e tyre, diktatura ka qenë sistemi i vetëm politik që njihnin, kështu që problemi i vetëm ishte që atyre t’u jepej një diktaturë oksidentale.<sup>19</sup> Ndërsa diktatura e majtë nuk kishte shanse të zhvillohej në Shqipëri, sepse mungonin kushtet shoqërore që do të bënin të mundur lindjen e saj dhe për më tepër, Evropa nuk do ta lejonte kurrë “diktaturën e kuqe” në Shqipëri: “pa u bërë e gjithë Evropa komuniste, ne shqiptarët, edhe sikur të bëhemi që të gjithë një milionë Leninër, prapë se prapë, Shqipërinë s’e bëjmë dot bollshevike”.<sup>20</sup> Prandaj, për Toton alternativa e vetme ishte diktatura e djathtë, e ngjashme me regjimet e kohës në Itali dhe Gjermani, por e përshtatur për kushtet shqiptare. Ai i bënte thirrje Mbretit që të hidhte tutje fasadën e monarkisë kushtetuese, të vihej në krye të brezit të ri dhe të shpallte diktaturën për të mirën e kombit.

Intelektualët që simpatizonin komunizmin dhe Bashkimin Sovjetik nuk përbënin as ata një grup homogjen. Brenda kufijve të lirisë së shtypit, ata e kritikonin qeverinë dhe sundimin e klasave të bejlerëve dhe borgjezisë. Ata gjithashtu ishin kritikë ndaj garës imperialiste të fuqive evropiane dhe varësisë së Shqipërisë ndaj Italisë. Disa nga publicistët e majtë dhe “demokratë” ishin anëtarë të grupeve të fshehta komuniste.

Megjithëse në favor të modernizimit të Shqipërisë, “demokratët” e kritikonin qytetërimin perëndimor duke u fokusuar në dy dukuri kryesore: kriza ekonomike dhe imperializmi. Ata theksonin kushtet e vështira të punëtorëve dhe fshatarëve në Shqipëri për shkakun e krizës së ekonomisë kapitaliste. Migjeni me ironi pretendonte se më në fund punëtori shqiptar ishte njëlloj si ai evropian, sepse që të dy ishin të papunë: “Vazhdon punëtori ynë t’u bijë pash më pash rrugave të qytetit. Kërkon punë. Si kolegët e tij në Berlin e në London”.<sup>21</sup> Nonda Bulka shkruante në mënyrë të ngjashme: “Mos quan vallë qytetërim shëtitjet nëpër rrugët e Londrës, të Nju-Jorkut ose të Berlinit, të miliona njerëzve që kërkojnë punë ose bukë”.<sup>22</sup>

Te artikujt e Bulkës ndeshet edhe kritika ndaj imperializmit. Ai përshkruante marrëdhëniet e tensionuara ndërkombëtare, sidomos garën e re

<sup>17</sup> *Po aty*, f.150.

<sup>18</sup> *Po aty*, f.189; V. Koka, *Rrymat e mendimit...*, f.61.

<sup>19</sup> I. Toto, *Bota e një djali...*, f.161, 175.

<sup>20</sup> *Po aty*, f.78.

<sup>21</sup> Migjeni, *Vepra...*, f.86.

<sup>22</sup> Nonda Bulka, *Vepra letrare, vëll. 1*, Tiranë: “Naim Frashëri”, 1980, f.25.

imperialiste për koloni. Në një artikull ai vë në lojë pretendimet qytetëruese të Oksidentit nën dritën e luftës në Etiopi:

Në ato kohëra... (të Noesë) rronte një popull i madh e i qytetëruar që quhej “popull evropian”. Njerëzit që e përbënin këtë popull ishin të ndarë në kombe të ndryshme dhe haheshin si qentë midis tyre. Këta popuj të qytetëruar (që haheshin si qentë midis tyre) vendosën të përhapin qytetërimin përtej kufijve të Evropës.<sup>23</sup>

Më këtë mënyrë Britania dhe Franca “qytetëruan” qindra milionë afrikanë dhe aziatikë, u mësuan atyre anglisht dhe frëngjisht dhe u shitën mallra për të cilat afrikanët dhe aziatikët nuk kishin nevojë. Tani që në garë po hyn edhe Italia, Britania i thotë: “Jo s’është aspak njerëzore të sundosh një popull të huaj. Në emër të qytetërimit je e ndaluar të zaptosh Abisininë...”<sup>24</sup>

Intelektualët e majtë me gjuhë alegorike vërenin se edhe Shqipëria ishte kthyer në viktimitë të imperializmit italian. P.sh. Petro Marko për të demaskuar premtimet “oksidentale” të qeverisë “liberale” të Mehdi Frashërit shkruan se nuk duhet pritur që punët tani e tutje të venë më mirë se më parë, sepse vërtet është ndërruar motori, por benzina është po ajo, e AGIP-it, kompania italiane për shfrytëzimin e naftës shqiptare.<sup>25</sup> “Demokratët” refuzonin aspektet borgjeze të qytetërimit evropian dhe kërkonin t’i përkushtonin energjitë e tyre për një sistem alternativ shoqëror që njëkohësisht të ishte modern dhe prej tij të përfitonin masat e fshatarëve dhe punëtorëve.

### Përfundime

Nocioni i “rikthimit në Evropë” ka pasur një apel të fuqishëm në vendet e Evropës lindore gjatë tranzicionit dhe shumë evropiano-lindorë e shikojnë me nostalgji periudhën midis dy luftërave si koha kur vendi i tyre ishte pjesë e qytetërimit perëndimor. Me fjalë të tjera, “rikthimi në Evropë” interpretohet si “rikthimi në histori”, pas “pauzës” së gjatë të komunizmit. Gjatë debateve të sotme për identitetin “evropian” të shqiptarëve, argumentet e parashtruara nga intelektualët e viteve 20-30, për “oksidalizmin” e Shqipërisë sot paraqiten si një tregues i prirjes evropianiste të shqiptarëve me të cilën rëndom nënkuptohen ekonomia e tregut, demokracia liberale dhe respekti për të drejtat e njeriut. Mirëpo vizionet intelektualëve të atëhershëm shqiptarë për Evropën jo gjithmonë përputhen dhe përshtaten me konceptimet që kemi sot për Evropën dhe Bashkimin Evropian. Për shembull, mund të lexojmë në shtyp një artikull

<sup>23</sup> *Po aty*, f.335.

<sup>24</sup> *Po aty*, f.336.

<sup>25</sup> Petro Marko, *Ditën që rrojta unë*, Tiranë: “Kokona”, 2004, f.24.

tepër lavdërues për “oksidantalizmin” e Ismet Totos,<sup>26</sup> ku nuk përmendet programi i tij i “diktaturës së ndritur”. Ngjashëm, sot është më e lehtë që të akuzohen intelektualët e majtë të viteve 20-30 se po e përdornin “oksidantalizmin” për të maskuar veprimtarinë e tyre subversive për vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri, që realisht e izoloi vendin prej ndikimeve nga Perëndimi.<sup>27</sup>

Siç tregon rasti shqiptar, megjithë shfaqjen e shpeshtë të shënjesit “Oksident”, duhet të jemi të kujdesshëm kur në ligjërimin intelektual të atyre viteve kërkojmë frymëzim për proceset e sotme të integritit me Evropën/Perëndimin. Të mbajmë parasysh se si komunizmi, si fashizmi në Evropën e viteve 20-30 mbaheshin si rrugë të mundshme për të avancuar ose rigjeneruar qytetërimin evropian. Integrimi i vendeve të Evropës Lindore në BE (dhe NATO) varet mbi të gjitha nga demokratizimi, respektimi i të drejtave të njeriut, shteti ligjor dhe ekonomia funksionale e tregut, që shihen si mjete edhe për të shëruar plagët që totalitarizmat e shek. XX shkaktuan në kontinent, si edhe për të ndërtuar një të ardhme për popujt e kontinentit që të jetë e ndryshme nga e shkuara.

Për më tepër, përmasa kulturore e globalizimit që shoqëron evropianizimin, kërkon një hapësirë më të madhe të dialogut me kultura të ndryshme, si brenda Evropës, po ashtu edhe jashtë saj. Një “rikthim” ideologjik të “rrënjët”, “e shkuara”, “tradita” etj., evropiane mund të na çojë te kurthi orientalist dhe te thirrjet për të mbrojtur “qytetërimin” kundër “barbarëve” të portat dhe atyre brenda tij. Një qasje kulturore esencialiste ndaj evropianitetit mund të ngrejë mure të tjerë në kontinent, ndoshta më të butë se sa Perdja e Hekurt, por megjithatë me efekte të hidhura.

---

<sup>26</sup> Nasho Jorgaqi, “Ismet Toto, personazhi që nuk pajtohej me asnjë grimë të të kaluarës orientale”, *Gazeta Shqiptare* (shtojca kulturore *Milosao*), Tiranë, 20.07.2008.

<sup>27</sup> Aurel Plasari, “Kundërbota e Branko Merxhanit”, në: Branko Merxhani, *Vepra*, Tiranë: “Plejad”, 2003, f.12.